

RREGULLORE E LOJES SE FATIT PROMOCIONALE

"Credins Shperblen"

Kjo rregullore hartohet ne baze te neneve 17, pika 5, e 70, pika 5, te ligj. it nr.155/2015, "Per lojrat e fatit ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, dhe Vendimin nr.196, date 15.03.2017, te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e menyrave, formave, kriterëve dhe rregullave per organizimin e lojerave te fatit promocionale".

NENI 1

ORGANIZIMI I LOJES PROMOCIONALE

"BANKA CREDINS" Sh.a, me adrese Rr. "Vaso Pasha", Nr.8, nje shoqeri e krijuar qe vepron si person juridik ne baze te ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane, NR.28969, Dt.31.01.2003, e regjistruar ne Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr.3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencen Nr.16, Dt.31.03.2003 te leshuar nga Banka e Shqiperise, perfaqesuar nga zv.Drejtores e Pergjithshme, Znj.Monika Milo, referuar ketu me poshte si "Credins".

Banka Credins Sh.a eshte i regjistruar si subjekt tatimpagues ne Drejtorine Rajonale Tatimore te Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane.

NENI 2

AFATI

Loja promocionale do te zhvillohet ne nje periudhe kohore prej 9 Muajsh. Loja promocionale do te filloje ne date 01.03.2024 dhe do te perfundoje ne daten 31.12.2024. Loja promocionale do te kryhet ne periudhat kohore si me poshte:

1. **Perdorimi i te gjithe llojeve te kartave bankare Visa & Mastercard Credins per te pakten 2 here online dhe ne POS.**
 - I. 01.03.2024 – 31.03.2024
 - II. 01.04.2024 – 30.04.2024
2. **Perdorimi i kartave bankare te kreditit Mastercard Credit per te pakten 2 here online dhe ne POS.**
 - III. 01.05.2024 – 31.05.2024
 - IV. 01.06.2024 – 30.06.2024
3. **Perdorimi i te gjithe llojeve te kartave bankare Visa & Mastercard Credins per te pakten 2 here online dhe ne POS.**
 - V. 01.07.2024 – 31.07.2024
 - VI. 01.08.2024 – 31.08.2024

4. Te gjithë klientet e rinj apo ekzistues që hapin për herë të parë aplikacionin Credins Online.

VII. 01.09.2024 – 30.09.2024

VIII. 01.10.2024 – 31.10.2024

5. Përdorimi i të gjithë llojeve të kartave bankare Visa & Mastercard Credins për të paktën 3 herë online dhe në POS.

IX. 01.11.2024 – 30.11.2024

X. 01.12.2024 – 31.12.2024

Nepermjet Lojerave Promocionale gjatë periudhës 1-2, 5-6, 09-10, Credins ka për qëllim përdorimin e kartave bankare, me qëllim reduktimin e përdorimit të cash-it në qarkullim duke përdorur mjete siç janë kartat bankare për pagesa të ndryshme

Për Lojerat Promocionale të periudhës 3-4 synohet nxitja e të gjithë klienteve kartembajtes Mastercard **Credit** të përdorin kartat e tyre të kreditit për pagesa të ndryshme online, POS, etj.

Për Lojerat Promocionale të periudhës 7-8 synohet rritja e klienteve që hapin aplikacionin Credins Online.

Nepermjet kësaj loje fati promocionale Banka Credins sh.a do të shpërblejë klientet fitues me cmimet e percaktuara në nenin 6 të kësaj rregullore

NENI 3

PJESEMARRJA

Pjesëmarrës në këtë Lojë Fatë Promocionale kanë të drejtë të jenë:

- Të gjithë kartembajtesit e kartave Credins që kryejnë të paktën 2 pagesa nepermjet kartave të tyre në muaj.
- Të gjithë kartembajtedit e kartave Mastercard krediti që kryejnë të paktën 2 pagesa në muaj
- Të gjithë personat kliente ekzistues apo të rinj që hapin për herë të parë aplikacionin Credins Online.

Nuk mund të marrin pjesë në këtë Lojë Fatë Promocionale punonjësit e Banka Credins sh.a. Numri i parashikuar i pjesëmartësve është përafërsisht 50.000.

NENI 4

TERRITORI

Lojë promotionalë do të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 5

MEKANIZMI I LOJES PROMOCIONALE

Hedhja e secilit shortë dhe shpallja e klienteve fitues do të bëhet pranë zyrave qendrore të Banka Credins me vendndodhje në Rr. "Vaso Pasha", nr. 8, Tiranë, Shqipëri, ditën percaktuar me poshtë, që i korrespondon secilës periudhë të shorteut. Ora e hedhjes së çdo shorteu do të jetë 12:00 am dhe emrat e fituesve do të publikohen në rrjetet sociale të bankës Credins. Hedhja e shorteut për lojën promotionalë do të bëhet në varesi të periudhës kohore të lojës së fatit promotionalë.

- Perdorimi i te gjithë llojeve të kartave bankare Visa & Mastercard Credins për të pakten 2 here online dhe në POS. Hedhja e shorteut do të bëhet në datat si më poshtë:

01.03.2024 – 31.03.2024: shorteu do të hidhet në datën 09.04.2024 ditë e martë.

01.04.2024 – 30.04.2024: shorteu do të hidhet në datën 08.05.2024 ditë e mërkurë.

- Perdorimi i kartave bankare të kreditit Mastercard Credit për të pakten 2 here online dhe në POS. Hedhja e shorteut do të bëhet në datat si më poshtë:

01.05.2024 – 31.05.2024: shorteu do të hidhet në datën 06.06.2024 ditë e enjte.

01.06.2024 – 30.06.2024: shorteu do të hidhet në datën 10.07.2024 ditë e mërkurë.

- Perdorimi i te gjithë llojeve të kartave bankare Visa & Mastercard Credins për të pakten 2 here online dhe në POS. Hedhja e shorteut do të bëhet në datat si më poshtë:

01.07.2024 – 31.07.2024: shorteu do të hidhet në datën 07.08.2024 ditë e mërkurë.

01.08.2024 – 31.08.2024: shorteu do të hidhet në datën 11.09.2024 ditë e mërkurë.

- Të gjithë klientet e rinj apo ekzistues që hapin për here të parë aplikacionin Credins Online. Hedhja e shorteut do të bëhet në datat si më poshtë:

01.09.2024 – 30.09.2024: shorteu do të hidhet në datën 10.10.2024 ditë e enjte.

01.10.2024 – 31.10.2024: shorteu do të hidhet në datën 07.11.2024 ditë e enjte.

- Perdorimi i te gjithë llojeve të kartave bankare Visa & Mastercard Credins për të pakten 2 here online dhe në POS. Hedhja e shorteut do të bëhet në datat si më poshtë:

01.11.2024 – 30.11.2024: shorteu do të hidhet në datën 11.12.2024 ditë e mërkurë.

01.12.2024 – 31.12.2024: shorteu do të hidhet në datën 09.01.2025 ditë e enjte.

Të gjitha shortet do të zhvillohen duke filluar nga ora 12:00 e datës së fillimit të shorteut deri në orën 23:59 të datës së fundit të shorteut.

Menyra e perzgjedhjes së fituesve

Në çdo sesion që do të hidhet shorteu, shpallja e klientit fitues do të bazohet në një perzgjedhje rastësore, nëpërmjet sistemit, i cili perzgjedh automatikisht dhe në mënyrë rastësore 1 emër klienti që shpallet fitues. Pjesa tjetër e emrave të klienteve në këtë listë do të shërbejnë si listë rezerve në rast se fituesi i sesionit nuk do të pranojë apo nuk do të kualifikohet për tërheqjen e çmimit sipas kriterit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Çdo klient mund të shpallet vetëm një herë fitues gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj loje promovionale. Klientet që kanë qenë pjesë e shorteut paraardhës do të jenë automatikisht të skualifikuar për të qenë pjesëmarrës në shorteun pasardhës.

Banka Credins sh.a do perdore programin **Pick a Random Number** i cili eshte perdorur edhe gjate vitit 2022 dhe 2023 ne fushata te ngiashme promovionale, ne presence te stafeve te institucioneve perkatese. Shorteu dhe shpallja e numrit fitues do te zhvillohet ne pranine e nje noteri, nje perfaqesuesi te AMLF-se, perfaqesues te Deges Rajonale te Njesise se Tatimpaguesve te Medhenj Tirane te cilet do te njoftohen nga Banka Credins Sh.a sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ne prani te Komisionit te Lojes se Fatit Promovionale te ngritur ne kite rast nga ana e "Banka Credins" Sh.a.

Identifikimi i fituesve dhe dhenia e cmimeve do te behet ne adresen e sipercituar pas ezaurimit te procedures se percaktuar ne nenin 7 te kesaj Rregullore.

Pas konfirmimit te te dhenat per fituesit e udhetimeve turistike, e gjithë pergjegjesia e mbarevajtjes se udhetimeve i kalon agjencise turistike Executive Travel & Tours Albania, me te cilen Credins eshte partnere per te mundesuar kete shorte.

Fituesit e udhetimeve nuk kane mundesine ta transferojne cmimin tek dikush tjeter.

NENI 6

CMIMET

Credins do te shpalle 1 fitues ne secilen nga datat e hedhjes se shorteut sipas percaktimeve ne nenin 5. Pjesemarrjesit ne loje nuk duhet te pagujne vlere monetare per pjesmarrje ne loje.

Cmimet qe do te jepen nga Credins per secilin prej fituesve te Lojes Promovionale perfshijne:

- Te gjithë kartembajtesit e kartave Credins qe kryejne te pakten 2 pagesa nepermjet kartave te tyre ne muaj (Periudha I-II). Ata do te perfitojne udhetim cift jashtë Shqiperise, ne total do te jepen 2 (dy) udhetime (Nje udhetim cift per secilin shorte). Ne udhetime perfshihen:
 1. Berlin, fluturimi + akomodimi per 2 nete, per 2 persona. Datat e udhetimeve jane 19 – 21 Prill 2024. Vlera totale eshte 600 euro me TVSH
 2. Paris, fluturimi + akomodimi per 2 nete, per 2 persona. Datat e udhetimeve jane 17-19 Maj 2024. Vlera totale eshte 630 euro me TVSH
- Te gjithë kartembajtesit e kartave Mastercard krediti qe kryejne te pakten 2 pagesa ne muaj (Periudha III-IV). Ata do te perfitojne Samsung Galaxy A54, me vlere 29.990 lek me TVSH, ne total do te jepen 4 (kater) (dy per secilin shorte).
- Te gjithë personat kliente egzistues apo te rinj qe hapin per here te pare aplikacionin Credins Online (Periudha V-VI). Ata do te perfitojne udhetim cift jashtë Shqiperise, ne total do te jepen 2 (dy) udhetime (nje udhetim cift per secilin shorte). Ne udhetime perfshihen:
 1. Venecia, fluturimi + akomodimi per 2 nete, per 2 persona. Datat e udhetimeve jane 16 – 18 Gusht 2024. Vlera totale eshte 490 euro me TVSH
 2. Milano, fluturimi + akomodimi per 2 nete, per 2 persona. Datat e udhetimeve jane 20-22 Shtator 2024. Vlera totale eshte 600 euro me TVSH

- Te gjithë kartembajtesit e kartave Credins që kryejnë të pakten 2 pagesa nëpërmjet kartave të tyre në muaj (Periudha VII-VIII, IX-X). Ata do të përfitojnë Samsung Galaxy A54, me vlerë 29.990 lek me TVSH, në total do të japin 8 (tete) (dy për secilin shorte).

Fituesi i shorteut të parë nuk do të mund të përzgjidhet sërisht në shorteun pasardhës. Pra, fituesi nuk mund të fitojë këtë çmim me shumë se një herë.

Credins mund të refuzojë dënimin e çmimit në rast se konstaton se nuk janë respektuar kushtet e kesaj Rregulloreje, apo në rast se fituesi/t rezultojnë të tillë si rezultat i ndonjë parregullsie që do të verifikohet gjithashtu përzgjedhja e fituesit tjetër do të bëhet në shorteun e radhës pa ndryshuar numrin e fituesve që është deklaruar në rregullore.

NENI 7

NJOFTIMI I FITUESVE

Fituesit do të njoftohen nga ana e "Bankes Credins" sh.a mbi fitimin e çmimeve sipas mënyrës së detajuar të përcaktuar si vijon:

Fituesit do të njoftohen menjëherë pas hedhjes së shortit përmes një telefonate në numrin e dhënë pranë Credins dhe do t'ju kërkohet të paraqiten në bankë brenda 30 ditëve nga momenti i njoftimit. Fituesit në momentin e paraqitjes në bankë duhet të jenë të pajisur me një mjet identifikimi kartë identiteti ose pashaportë. Nëse personi fitues nuk përgjigjet në telefon, atëherë do përdoret lista rezerve.

Nëse fituesit nuk arrijnë të paraqiten brenda afatit të lartpërmendur, apo për çfarëdolloj arsye tjetër nuk mund ta pranojnë çmimin, fituesit e humbasin të drejtën e përfitimit të çmimit të fituar.

Çmimi është i patransferueshëm dhe i pashkëmbyeshëm pavarësisht çdo rrethane apo situatë. Të gjitha çmimet do të akordohen gjatë ceremonisë së dënimës së çmimeve që do të organizohet pranë zyrave qendrore të Credins për qytetin e Tiranës dhe/ose në degen e bankës në qytetin përkatës ku çmimi është fituar.

NENI 8


TE DHENAT E PJESEMARRESVE

Çdo pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale pranon shprehimisht se Credins mund të përpunojë të dhënat e tyre personale sipas Nenit 7 pika 1 paragrafi a) i kesaj Rregulloreje për qëllimet e kesaj Lojë Fati Promocional edhe për çdo qëllim tjetër të ligjshëm të Banka Credins Sh.a në përputhje me Ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Udhezimin Nr.20 datë 03.08.2012 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar".

Keto të dhëna të mbahen për një periudhë jo më të gjatë se 6 vjet.

NENI 9

TAKSA DHE TATIMET



Te gjitha detyrimet mbi Taksen e Vleres se Shtuar qe lidhen drejtperdrejt me cmimin do te mbuloen nga Credins. Fituesi nuk do te jete subjekt detyrimesh, tarifash apo garancish qe kane lidhje te drejteperdrejte me cmimin pervec atyre te cilat mund te kerkohen detyrimisht per perfituesin nga legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 10

PUBLICITETI

Komunikimi i Lojes Promocionale do te behet nepermjet rrjeteve sociale te bankes (si psh: Facebook, Instagram, LinkedIn, etj). Gjithashtu per kete qellim do te kete deklarata per shtyp dhe artikuj te ngjashem ne faqen zyrtare te internetit te Banka Credins www.bankacredins.com dhe ne faqen zyrtare ne:

- Facebook: <https://www.facebook.com/credinsbank>
- Instagram: <https://www.instagram.com/credinsbank>
- LinkedIn: <https://www.linkedin.com/company/credins-bank>

NENI 11

FORCA MADHORE

Loja Promocionale mund te nderpritet vetem ne rastin e rrethanave per te cilat Credins nuk eshte pergjegjese, dmth., qe nuk mund te parandalohen, riparohen apo shmangen dhe ne rast te ndonje urdherimi sipas ligjeve ne fuqi nga autoritetet shtetore. Njoftimi per nderprerjen e lojes nga rrethanat e lartpermendura dhe cdo njoftim tjeter i iendesishem ne lidhje me Lojen e Fatit Promocionale, do te publikohet ne faqen zyrtare ne internet www.bankacredins.com

NENI 12

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Me perdorimin e kartave sipas periudhes se siperctuar dhe hapjes se aplikacionit Credins Online, klientet behen automatikisht pjese e shorteut per te fituar dhuraten sipas lojrave te siperpermendura. Ne rast te kerkesave te klienteve per te mos u perfshire ne kete Loje Promocionale, Banka Credins Sh.a do te marre pelqimin e tyre dhe nuk do t'i perfshije ata ne shortin qe do te hidhet per shpalljen e fituesve. Ne rast mosmarreveshjesh, organi kompetent per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 13

TE NDRYSHME

Per cdo shorte qe do te hidhet do te mbahet proces verbal ne perfundim te tij gjithashtu cdo procesverbali do ti bashkengjitet dhe ID e fituesit. Ne total do te jene 16 procesverbale dhe 16 ID.

"Banka Credins" sh.a rezervon te drejten qe per shkaqe te perligjura qe lidhen me mbarevajtjen e lojes, ta anulloje ate ne cdo kohe.

Rregullorja e Lojes Promocionale do te publikohet edhe ne faqen e internetit te Credins, www.bankacredins.com.

Informaliteti mbi Lojen Promocionale mund te merret gjithashtu prej Sherbimit per Kujdesin e Klientit duke telefonuar ne numrin +355 4 53 53 000.

Tirane, me 6.02.2024

Per Banka Credins sh.a

Monika Milo

ZV. DREJTORE E PERGJITHSHME

